

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shërbim për riparimin dhe mirëmbajtjen e sobave profesionale me gaz”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

50531200-8 - Shërbime për mirëmbajtje pajisjeve me gaz,

VLERA E FONDIT LIMIT:

15 374 000,0 *(pesëmbëdhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë)* **Lekë pa TVSH.**

Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është: 284 355,0** *(dyqind tetëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë)* **Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtorja e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Perlllogaritja e fondit limit është kryer mbështetur në nenet 12 dhe 13 të VKM nr 285 date 19.05.2021, Neni 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” pika c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore dhe Udhezimin nr 30 date 27.12.2011 ” Mbi menaxhimin e aktiveve në njesite e prokurimit publik”, të ndryshuar, Kapitulli II, pika 23. Masat që duhet të ndërmerren në raport me riskun për kufizimin e humbjeve financiare.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik ofertues te vertetoje që:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi Ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43 pika 2/c dhe pika 3 VKM Nr.285 dt 19.05.2021 (te ndryshuar).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Argumentimi i AK : *Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion te realizimit me sukses te kontrates.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.1 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:

a. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale e cila të përmbajë kategoritë, sipas modelit të lëshuar nga MPPT:

NS – 12 (A) Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

2.1.2 Përsa i përket aftësisë teknike dhe profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të vendosura nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

a. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësive, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. (dokumentacioni të paraqitet në gjuhën shqipe ose i perkthyer dhe e noterizuar).

b. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me ISO 14001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. (dokumentacioni të paraqitet në gjuhën shqipe ose i perkthyer dhe e noterizuar).

Enti çertifikues për lëshimin e çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i njohur nga Drejtoria e Akreditimit Shqiptar. Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike çertifikatat janë të detyrueshme për të gjithë operatorët sipas llojit dhe sasisë së shërbimeve

ARGUMENTIMI: Në bazë të Neni 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve, pika 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; si dhe në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit”, Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”.

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë **3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, jo më pak se 20 % të vlerës së përllogaritur të marrëveshjes kuadër (Fondi Limit ose vlera e kontratave të pritshme).

Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ARGUMENTIMI: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4, b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2 Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre specialistët e domosdoshëm për të realizuar objektin e këtij prokurimi si mëposhtë minimumi:

a. 6 (gjashtë) punonjës të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën minimumi Tetor - Dhjetor 2023

b. 1 (nje) Inxhinier Mekanik

b. Disponimi i specialistëve teknikë për objektin e këtij prokurimi

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë specialiste që figurojnë në listepagese të pakten 2 muajt e fundit me kodet perkatese sipas profesioneve të punës minimumi:

- 1 (nje) punonjës mekanik, i kualifikuar, i pajisur me diplome të shkolles së mesëm profesionale mekanike

- 2 (dy) punonjës elektrikistë, të jete të pajisur edhe me dëshmi kualifikimi nga organizëm i akredituar në Shqipëri..

- 1 (një) punonjës të trajnuar nga organ i licensuar për ndërhyrjen ndaj emergjencave dhe ndihmën e parë.

• Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë “Dokumentin e Vleresimit të Riskut (DVR)”, në pajtim me Ligjin nr 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shendetin në Punë”, i ndryshuar, sipas fushës së objektit të veprimtarisë. (në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, mjafton disponueshmëria e 1 DVR për të gjithë BOE)

(Kriteret 2.3.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.)

Shënim: Një punonjës mund të ketë më shumë sesa një kualifikim/ trajnim nga ato të kërkuara më sipër.

Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të lëshuar nga Administratori i shoqërisë, person përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj kontrate, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Diplomë
- Kontrata pune të vlefshme

ARGUMENTIMI: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e sobave profesionale me gaz, që kanë nevojë për kryerjen e shërbimeve si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen dhe rrezikshmërinë e lartë të përdorimit jashtë kushteve teknike të gazit si lëndë djegëse. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, numri i punonjësve të kërkuar, në bazë të kërkesës së Autoritetit Kontraktor, për realizimin e objektit.

Operatori ekonomik ofertues duhet të disponoje “Dokumentin e Vleresimit të Riskut (DVR)”, në pajtim me Ligjin nr 10237, date 18.02.2010 “Per sigurine dhe Shendetin ne Pune”, i ndryshuar, sipas fushes se objektit te veprimtarise. (ne rast bashkimi operatoresh ekonomike, mjafton disponueshmeria e një DVR per te gjithë BOE).

ARGUMENTIMI: Në bazë të Neni 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave, pika 7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

- c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën:

1 (një) automjet per transportin e mallrave, të cilat duhet t’i ketë në pronësi/me qira/mbështetje nga një operator ekonomik;

1 (një) motocikleta për riparimet emergjente të cilat duhet t’i ketë në pronësi/me qira/mbështetje nga një operator ekonomik;

Për vërtetimin e kësaj kërkesë duhet të paraqesë, Leje Qarkullimit, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, Akt-kontrollin teknik (Kolaudimin) të vlefshme), ose në rast se nuk i ka në pronësi të paraqesë kontratën e qirasë ose një deklaratë mbështetje nga një operator ekonomik ku të deklarohej se mbështetja e tij për këtë kapacitet teknik ofrohet për një afat sa kohëzgjatja e kontratës së parashikuar si dhe dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e mjeteve të kërkuara (Leje Qarkullimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, akt-kontrollin teknik (Kolaudimin) të vlefshme).

(Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.)

ARGUMENTIMI: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Objektet kopshte dhe çerdhe gjithsej 70 (shtatëdhjetë) janë të shpërndara në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, pra kanë një shtrirje në distanca mjaft të mëdha, si dhe shumica e tyre janë në zona ku ka trafik gjatë gjithë orarit të kërkuar për ndërhyrje riparimi dhe shërbimi teknik (07:00 deri 17:00). Njëkohësisht paraqitet edhe prania e riskut të përdorimit të pakujdesshëm të gazit prandaj mjetet motciklela janë mjeti më i shpejtë për të arritur në objekt specialisti/tekniku.

.....
.....
(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës).

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.....
.....

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

ARGUMENTIMI LIGJOR: Parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

ARGUMENTIMI I AK: *Gjate hartimit te specifikimeve teknike dhe termave te references AK i eshte referuar dhe bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit public. duke u bazuar në inventarin ekzistues, kontratën e ngjashme të zbatuar nga vetë Autoriteti Kontraktor në vitin 202, si dhe sipas manualeve të secilës markë të sobave që janë objekt mirëmbajtje.*

AK ne asnje rast nuk ka përdorur emra markash/standartesh por në përgjithsi njofton se janë në inventar mirëmbajtjeje pothuaj të gjithë market e tregtuara në vendin tonë dhe në çdo rast standartet apo kerkesat e performances jane shoqeruar me fjalet “ose ekuivalent”.